



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 31/2008), nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-87 Për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 177 të Ligjit nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 25 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.10.2022, mori vendim të publikojë:

K O N K U R S I N PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: **Kryeshef Ekzekutiv të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë**

1. Të përgjithshme:

Kandidati për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili i plotëson kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të ketë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

2. Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv:

Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tre) vjetëve, me mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

3. Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv:

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshefit Ekzekutiv do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, në përputhje me deklaratën për politiken e kompensimit të ndërmarrjes.

4. Përshkrimi i punëve:

- Në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Drejtorëve, udhëheq zhvillimin strategjik të Ndërmarrjes;
- Harton, udhëheq dhe mbikëqyrë implementimin e planit të biznesit të ndërmarrjes, planeve afatshkurtra dhe afatmesme të ndërmarrjes në akord me strategjinë e ndërmarrjes, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve;
- Është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të ndërmarrjes, përmes varësve të paraparë, duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjate financiare të saj;
- Siguron vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të informacionit duke i mundësuar ndërmarrjes të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etike;
- Vepron si ndërlidhje në mes të Menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve, komunikon në mënyrë efektive me palët e ndërlidhura, punëtorët e saj, Komunën e Prishtinës, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë apo Agjencitë e saj, Institucione tjera të interesit, si dhe publikun;
- Organizon, mbikëqyrë dhe mbanë përgjegjësi për të gjitha çështjet e biznesit të ndërmarrjes të cilat nuk janë në kompetencë të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm;
- Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe aktet tjera të brendshme të ndërmarrjes.

5. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- Të ketë përgatitje superiore (diplomë universitare) në fushat ekonomike, juridike, teknike apo në fusha të tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron ndërmarrja;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e lartë;
- Të ketë shkathësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Integritet të lartë profesional dhe etik;
- Shkathësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohja e mirë e gjuhëve zyrtare në të lexuar dhe të shkruar si dhe njohja e gjuhës angleze e (dëshiruar).
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësoj të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimet përkatëse, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në ushtrimin e funksionit publik nr.06/L-011, si dhe me normat tjera pozitive relevante.

6. Informatë për procedurën e konkurrimit

Dokumentet e nevojshme për konkurrim janë si më poshtë:

- Formulari i aplikimit;
- CV;
- Letër motivimi;
- Dëshmi mbi kualifikimin profesional;
- Dëshmi mbi përvojën e punës dhe shkollimin;
- Certifikatë që nuk është nën hetime;
- Kopje e letërnjoftimit;
- Deklarata nën betim;
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

7. Të interesuarit mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre me dokumentet tjera relevante në arkivin e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, Rr. Luan Haradinaj p.nr., Prishtinë, duke filluar nga data **27.10.2022 deri me datën 26.11.2022** çdo ditë pune prej orës **8:30 – 15:30**, të adresuara për: “Bordin e Drejtorëve” të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.

8. Formulari për aplikim, Lista e Dokumenteve të dorëzuara dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga *web-faqja* e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com> ose mund të merren në zyret e Ndërmarrjes.